



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq


Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenin 44 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-I-95, të dt.29.06.2018, Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës së drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencave me nr.06-104/02-15443/26 të dt.03.06.2026 në mbledhjen e mbajtur me dt.30.06.2026 mori këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet subvencionimi për xhaminë e fshatit Raskovë, përmes Këshillit të Bashkësisë Islame në Obiliq në vlerën prej 8,000euro (tetë mijë euro) për përfundimin e abdes-hanes dhe tualeteve
2. Mjetet do të ndahen nga kategoria Subvencione dhe Transfere, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (DSHPE).
3. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Nënkyetarit të Komunës
- Anëtarëve të KK
- DEFZH
- DSHPE
- MAPL
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Sami Ahmeti